



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:274485

Datë: 20.09.2024

Numri i dokumentit: 06190445

C.nr.1981/19

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN- Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Shaban Shala, me praktikanten gjyqësore E.D. në çështjen juridike të paditësve M.G., S.K., R.B., M.B., D.S., B.Ç., N.B., B.D., M.S. dhe K.R. të cilët me autorizim i përfaqëson avokati Asdren Saramati nga Prishtina, rr. Garibaldi, nr. 61, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të ushqimit- shujtave ditore, me vlerë të kontestit 3510,00 €, pas dhënies së përgjigjes në padi, me datën 20.09.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M
-pa shqyrtim kryesor të çështjes-

APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve **M.G., S.K., R.B., M.B., D.S., B.Ç., N.B., B.D., M.S., K.R.** dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim ditor-shujtave për vitin 2021, t'ia paguaj paditësve shumat si në vijim:

Paditësit **M.G.** për 174 ditë pune brenda vitit 2021, shumën prej 348,00 € (treqind e katërdhjetë e tetë) euro.

Paditësit **S.K.** për 173 ditë pune brenda vitit 2021, shumën prej 346,00 € (treqind e katërdhjetë e gjashtë) euro.

Paditësit **R.B.** për 173 ditë pune brenda vitit 2021, shumën prej 346,00 € (treqind e katërdhjetë e gjashtë) euro.

Paditësit **M.B.** për 169 ditë pune brenda vitit 2021, shumën prej 338.00 € (treqind e tridhjetë e tetë) euro.

Paditëses **D.S.** për 149 ditë pune brenda vitit 2021, shumën prej 298.00 € (dyqind e nëntëdhjetë e tetë) euro.

Paditësit **B.Ç.** për 175 ditë pune brenda vitit 2021, shumën prej 350.00 € (treqind e pesëdhjetë) euro.

Paditësit **N.B.** për 174 ditë pune brenda vitit 2021, shumën prej 348.00 € (treqind e katërdhjetë e tetë) euro.

Paditësit **B.D.** për 171 ditë pune brenda vitit 2021, shumën prej 342.00 € (treqind e katërdhjetë e dy) euro.

Paditësit **M.S.** për 175 ditë pune brenda vitit 2021, shumën prej 350.00 € (treqind e pesëdhjetë) euro.

Paditësit **K.R.** për 222 ditë pune brenda vitit 2021, shumën prej 444.00 € (katërqind e katërdhjetë e katër) euro.

Të gjitha këto në afatin prej 7 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

II. DETYROHET e paditura që t'ia paguajë paditësit shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej 268,00 € në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

M.G., S.K., R.B., M.B., D.S., B.Ç., N.B., B.D., M.S. dhe K.R. të cilët me autorizim i përfaqëson avokati A.S. nga Prishtina, rr. Garibaldi, nr. 61, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shujtave - ushqimit gjatë punës, me vlerë të kontestit 3510,00 €.

E paditura duke vepruar sipas aktvendimit të gjykatës, më datë 15.06.2020 ka dorëzuar në gjykatë përgjigjen në padi me anë të së cilës e ka kundërshtuar në parim padinë dhe kërkesëpadinë me arsyetim se palëve paditëse nuk i takon kompensimi i shujtave me arsyetim se kompensimi për ushqim u takon personave që qëndrojnë në punë prej 8 orëve si dhe duke marrë parasysh se orari mësimor në të gjitha shkollat fillore është nga 4 orë në ditë apo 20 orë në javë, andaj asnjë nga mësimdhënësit e MASHT nuk qëndrojnë në punë për 8 orë të plota ditore. E paditura në përgjigjen në padi ka theksuar se Ministria e Financave ka për detyrë dhe është në përgjegjësin e saj ndarja e mjeteve financiare, prandaj e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë në tërësi.

Paditësi padisë i'a ka bashkangjitur provat materiale si në vijim: kopjen e letërnjoftimit të paditësit B.D. dhe paditësit B.Ç. kërkesën për pagesën e shujtave të datës 03.06.2019, vërtetimet për ditët e pranisë në punë për paditësit gjatë vitit 2021 të lëshuar nga Gjymnazi Gjon Buzuku në Prizren, të datës 01.02.2022, kopjen e kontratës së punës të lidhur ndërmjetë paditësve si punëmarrës dhe DKA në Prizren si punëdhënëse dhe autorizimet.

Nga provat e administruara më lartë nuk është kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura Gjinnazi Gjon Buzuku në Prizren, por mbetet kontestues fakti se paditësve a i takon kompensimi për ushqimin ditor, për të cilën çështje gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar për shkak se kjo kërkesë e paditësve është e rregulluar me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit nr. 01/B-105 të dt.22.01.2021 konkretisht me nenin 35.7 i cili rregullon të drejtën për shujtje-ushqim ditor për ditët e kaluara në punë, në rastet kur punëdhënësi nuk e ka organizuar ushqimin në punë sikurse në rastin konkret.

Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjygjëse dhe gjendjen faktike të vërtetuar, se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, ashtu që e detyroi të paditurën që paditësve t'ia kompenzon ushqimin ditor në shumën më detalisht të vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke llogaritur një ditë pune nga 2 € për shkak se nga provat materiale konkretisht vërtetimi i lëshuar nga vet e paditura vërtetohet fakti se paditësit M.G. dhe N.B. kanë 174 ditë pune, S.K. dhe R.B. kanë 173 ditë pune, B.Ç. dhe M.S. kanë 175 ditë pune, M.B. ka 169 ditë pune, D.S. ka 149 ditë pune, B.D. ka 171 ditë pune, si dhe K.R. ka 222 ditë pune tek e paditura dhe për këto ditë pune i takon shpërblimi i ushqimit ditor (shujtës).

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në nenin 449, 452 dhe 453.1 të LPK-së, ku është obliguar pala e paditur që paditësve t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 268,00 € dhe atë në emër të përpilimit të padisë 208.00 € dhe në emër të taksës për padi 60 € bazuar në tarifën e OAK-së.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
-Departamenti i përgjithshëm-
C.nr.1981/19, dt. 20.09.2024

Praktikantja
Erëza Danjoli

Gjyqtari
Shaban Shala

UDHËZIME PËR ANKESË: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.